

NDIKIMI I FILOZOFISË EKZISTENCIALISTE NË LETËRSINË FRËNGE TË SHEKULLIT XX SIPAS JEAN-PAUL SARTRE-IT

THE INFLUENCE OF EXISTENTIALIST PHILOSOPHY ON 20TH CENTURY IN FRENCH LITERATURE ACCORDING TO JEAN-PAUL SARTRE

Dëfrim SALIU¹, Shejnaze AJDINI-MURTEZI², Besa SALIU³

¹Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

²Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje

³Gymnasium „Kiril Pejčinović“ - Tetovo

*Corresponding author e-mail: defrim.saliu@unite.edu.mk

Abstract

What is existentialism? is a question that we encounter every time we hear this notion. However, what we can say from the beginning is that by existentialism we understand that doctrine that makes human life possible and that affirms that every truth and every action needs an environment and a human subjectivity, a definition that Jean-Paul Sartre gives in his work *Existentialism is a humanism* dedicated to existentialism immediately after the end of World War II in 1945.

Existentialism was initially a philosophical movement, but then it also passed into literature and was one of the most important literary movements in France at first, but also in other European countries. It is universally known that French existentialism begins with Jean-Paul Sartre and Albert Camus, they are two philosophers and writers who characterize existentialist literature.

Existentialism as a philosophical process at first did not deal with the beautiful idea of life observed romantically from the outside, but completely immersed in the river where you cannot bathe twice! Man, therefore, the human being before being defined and before being defined as ... man, exists! Existence itself is a fact and does not need to be proven on the rational plane, but the moment of awareness of it, according to Sartre, comes as a pure moment of discovery. The Sartrean atmosphere that man is what he is not, leads us to the conclusion that man exists.

Keywords: Sartre, philosophy, existentialism, French literature, influence.

Abstrakt

Ç'është ekzistencializmi? është një pyetje që e hasim çdo herë kur e dëgjojmë këtë nocion. Sidoqoftë ajo çka mund të themi qysh në fillim, është se me ekzistencializëm ne kuptojmë atë doktrinë që e bën jetën njerëzore të mundshme dhe që pohon se çdo e vërtetë e çdo veprim ka nevojë për një mjedis dhe një subjektivitet njerëzor, përkufizim ky që e jep Jean-Paul Sartre-i në veprën e tij *Ekzistencializmi është humanizëm* kushtuar ekzistencializmit fill pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945.

Ekzistencializmi në fillim ishte rrymë filozofike, por pastaj kaloi edhe në letërsi dhe ishte një ndër rrymat më të rëndësishme letrare në Francë, por edhe në vendet tjera europiane. Dihet mirëfilli se ekzistencializmi francez fillon me Jean-Paul Sartre-in dhe Albert Camus-në, dy filozofë dhe shkrimtarë që e karakterizojnë letërsinë ekzistencialiste.

Ekzistencializmi si proces filozofik në fillim nuk merrej me idenë e bukur të jetës, vëzhguar me romantizëm së jashtmi, por zhytet krejtësisht në lumin ku nuk mund të lahesh dot dy herë! Njeriu si qenie njerëzore përpara se të jetë i përcaktuar dhe përpara sesa të përcaktohet si ... *njeri*, ekziston! Vetë ekzistenca është fakt e s'ka nevojë të provohet në rrafshin racional, por momenti i ndërgjegjësimi për të, sipas Sartre-it vjen si një moment i pastër zbulimi. Atmosfera sartriane se *njeriu është ai që nuk është*, na çon në konkluzionin se *njeriu ekziston*.

Fjalët kyçe: Sartre, filozofi, ekzistencializmi, letërsi frënge, ndikimi.

Hyrje

Jean-Paul Sartre-i ka shkruar dhe ka publikuar punime të ndryshme filozofike. Në letërsi hyn me romanin *Neveria*, i botuar në vitin 1938. Vështrimet e tij të shkurtra në *La Nouvelle Revue Française* paralajmërojnë një polemikë me ide të reja e të fuqishme. *Neveria* nuk mund të konsiderohet krejtësisht si roman, më tepër është tregim me intenca filozofike. Synimi i tij nuk mund të vërehet menjëherë dhe për shumicën, intencat e autorit ngelin të pasqaruara.¹

Njeriu bëhet i ndjeshëm për shumë veçori të botës të cilën e ka krijuar autori. Është kjo botë e filozofit, po ashtu është edhe botë e një romancieri: botë e mbyllur hermetikisht, nëpër të cilën lëvizin symbyllazi të burgosur të ndryshëm, me ca lëvizje elastike nëpër një materie ngjitëse, viskoze. Trevë e një borgjezie të imtë provinciale, në të nuk ngjan asgjë, meqë e liga hyn e mishërohet në të edhe para se të dalë nga masa ngjitëse, e cila përpiket ta vë në lëvizje pikërisht këtë të ligë.

Jean-Paul Sartre romancier

Në shikim të parë heroin të cilin e prezenton Jean-Paul Sartre-i në romanin *Neveria*, duket i mjerë dhe i frikshëm, me vullnet të dobët, atë e ka thyer jeta e të tjerëve si dhe jeta e tij personale. Ai gjithmonë gjendet buzë njëfarë neverie që e shtyn ta hudhë përtej pamjen e tij të jashtme, me anën e së cilës shfaq historinë mediokre të ekzistencës së tij të pikëllueshme.

Kur mendon të bëjë vetëvrasje, zbulon se vetë vetëvrasja nuk do të kishte kurrfarë kuptimi. Ai është i *përrjashtuar* nga një botë *përplot* njerëz. Antoine Roquentin-i i kthen kësaj bote në mënyrë ideale të gjitha ato gjëra që bota ia ka imponuar atij, bota dhe ekzistenca që janë të tijat e që ai nuk i ka kërkuar. Duke përshkruar fatkeqësinë e vet, ai s'ka se si t'u shmanget shkaqeve të saj dhe pamjes së jashtme që e mundon. E konsideron veten të detyruar t'i paraqesë këto në ndonjë gazetë.²

Kështu, në saje të autorit, në vepër konstatohet procesi filozofik, shoqëror e politik i një bote, përmes së cilës kuptojmë se është e jona, botë çfarë nuk e kemi parë ende. Kjo nuk është aq shumë botë interesi, sa botë e një besimi të lig. Njëfarë pajtimi në heshtje konstatohet midis *të ndyerve*, atyre që mendojnë se kanë gjetur njëfarë vendi në shoqëri, e të cilin e zënë me plot vetëdije në mesin e viktimave të panumërta të kësaj shoqërie, të atyre që pajtohen me *rendin ekzistues*, ndonëse ky rend i shtyp e i copton.

Secili luan rolin e vet, si eksploatuesi ashtu edhe skllavi. Pjesa tjetër, në të cilën janë artistët e pandërgjegjshëm, tërësisht ngjan në atmosferën e formës së jashtme që është disi e butë. Ndërkaq, mjafton që një artist, siç është Antoine Roquentin-i, të dalë përnjëherë nga loja dhe të përpiket, para publikut syçelë, ta hedh përtej pamjen e jashtme, ta zbulojë artificialitetin e neveritshëm të një lufte shtazarake e organike. Vargu i pandërprerë i një jete që është konsideruar si e plotë, përmbush vrima, humnera, zbrazëtira. Kurse dekorët janë vetëm dekore, respektivisht anë e jashtme.³

Njeriu që vëren këtë *artificialitet* të botës, këtë realitet të ekzistencës, me të cilin është dënuar, përpiket të ikë prej tyre, duke iu drejtuar Zotit. Zoti është i shurdhër sa u përket klithjeve të njeriut. Hapësirat e zbrazta qiellore ia kthejnë njeriut jehonën e vajtimeve të tij. Kurrfarë ndihme nuk mund të pritët prej askujt. Individit mbetet në mëshirën e vetvetes të vetëdijes së vet, i dënuar që ta realizojë vetë lirinë e tij, duke marrë përsipër fatin e vet.

I tretur në vetmi, ai nuk gjen strehim tjetër pos kësaj vetmie dhe mbetet duke kërkuar kufinj të saj, për ta zbuluar edhe vetë vetminë. Po ndodhi që të mos gjejë në të bazë për dinjitetin e tij, këtë bazë e përfiton me anë të luciditetit, me anë të autentizmit. Në romanin *Neveria*,

¹ Jacques Deguy, 'La nausée' de Jean-Paul Sartre, Gallimard, Paris, 1993, f. 177.

² Lubisha Stefanoviq, *Zhan-Pol Sartri romancier*, Jehona nr. 6, Shkup, 1972, f. 26.

³ Jean-Paul Sartre, *Neveria*, Fan Noli, Tiranë, 2014, f. 18.

Roquentin-i del në fund vetëm të një pjesë të rrugës të tij, pjesës në të cilën heq dorë nga të gjitha. Ai e zbulon botën dhe në një masë të madhe, zbulon edhe vetveten e tij. Të gjithë këtë e bën për ta ndjerë anën e tij të *parëndomtë*, anën e tij joadekuate.⁴

Prej nga edhe vjen dëshira e tij për vetëvrasje, e nxitur gjithashtu nga ndjenja e vetmisë. Dorëheqja e tij nga kjo botë, nga të tjerët, nga vetë jeta shprehet me nuanca të ndryshme të një neverie të padurueshme organike. Atë e dënon me një vetmi dhe më të madhe, qoftë të shkëputet nga bota, qoftë të ngelë në të, asgjë nuk ndryshon, posaçërisht asgjë nuk ndryshon në mënyrën e jetesës në botë. Nëse gjatë frymëzimeve ta ndjejë *ekzistencën* e tij, pas kësaj zhytet edhe më thellë në një *artificialitet* që e merr me vete, duke e mbërthyer në kurthat e tij.

Novelat që janë pjesë e *Murit*, japin sqarime të reja me qëndrime filozofike, të cilat autori i ka skicuar edhe tek *Neveria*. Ato janë njëherit të maskuara më mirë, të inkarnuara më mirë në pikëpamje letrare. Në to ndjehet më mirë edhe farfuritja e një kohe. *Muri*, në të cilin dy revolucionarë spanjollë janë në pritje të pushkatimit të tyre, njeriun e paraqet në një situatë ekstreme. Kjo situatë pranohet në mënyrë të vetëdijshme, zotërohet, mposhtet.⁵

Kjo novelë nxjerr në planin letrar tërë tmerrin që mund të haset në tregimet e Edgar Allan Poe-s. *Érostrate-i*,⁶ që mban këtë emër në novelë, është njëherit Roquentin-i i *Neverisë*, i marrë nga shkak i luciditetit të tepruar. *Dhoma* është dashuri e shndërruar në një vetmi të mbyllur. *Fëmijëria e një padroni* (L'Enfance d'un chef) është besimi i lig që arrin edhe skajin e vet të fundit.

Angazhimi sartrian

Të treguarit e tij, Sartre-i e vendos buzë kufinjve të argumentimit, të cilin e sqaron dhe të cilit i jep kuptim të përgjithshëm që bie menjëherë në sy. Larg asaj që të jetë e padobishme, kjo ndërthurje radhit një nga një bazat e njëmendësisë. Në vend që ta mënjanojë me dhunë qëndrimin e lexuesit, autori e shtyn lexuesin të bashkëpunojë me të kur është fjala për hulumtime, e detyron t'i bëjë shoqëri nëpër shtigjet e tij të tërthorta, që në fund ta nxjerrë në dritë së bashku me vetëveten, pra rruga që ka ndjekur ai ka qenë e mirë. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për dinakëri filozofike. I mobilizuar, i burgosur nga ana e gjermanëve, pastaj i kthyer në atdhe, Jean-Paul Sartre-i gjatë kohës së okupimit, publikon veprën e tij kryesore filozofike *Qenia dhe hiçi* dhe kështu shënon fillimin e karrirës prej një dramaturgu.⁷

Pjesëmarrja në Rezistencën Franceze për çlirim nga okupatori gjerman, atij i sjellë, në radhë të parë, autoritet intelektual. Më 1945 publikon vëllimin e parë të disa veprave romantike me titull *Rrugët e lirisë*. Ai do ta paraqesë hovin e ngadalshëm të ndërgjegjes, pak a shumë të tjetërsuar, që zbulohet gjatë Luftës së Dytë Botërore. Idetë e tij filozofike së shpejti kurorëzohen me sukses. Në Francën anemike të pasluftës, ekzistencializmi bëhet modë, siç ishte surrealizmi pas viteve '20 të shekullit XIX. Shfaqen ithtarë dhe i huaji përgjon me kujdes se ç'është duke ngjarë rreth Saint-Germain-des-Prés.⁸

Gazetat mbushen përplot zënka lidhur me *angazhimin*. Sartre-i ndërkaq nuk dëshiron të jetë letrar në atë kuptim, siç ishin André Gide dhe Paul Valéry. Sikurse shkrimtarë të tjerë frëngë, ai ra nën ndikimin e André Malraux-së, pak më i vjetër se Sartre-i. Dihet se për Malraux-në, letërsia është një nga mënyrat për të marrë pjesë në tragjedinë e epokës. Sartre-i që vite me radhë e kundërshtoi politikën e Paul Nizan-it, pjesëmarrja në Rezistencës Franceze ia zhveshi realitetin që i shmangej dikur.

Në shprehjen e kësaj filozofie, parimet themelore të së cilës kishte shkruar t'i kërkojë në Berlinin e paraluftës të Martin Heidegger-it dhe Edmund Husserl-it, ai zbulon edhe nevojën për të

⁴ Lubisha Stefanoviq, *Zhan-Pol Sartri romancier*, Jehona nr. 6, Shkup, 1972, f. 28.

⁵ Zhan-Pol Sartër, *Muri*, Koha Ditore, Prishtinë, 2005, f. 9.

⁶ Novela *Herostrati* dhe *Prostituta e respektueshme*, janë veprat e para që përkthehen dhe botohen në Shqipëri për herë të parë në vitin 1992.

⁷ Emmanuel Mounier, *Introduction aux existentialismes*, Gallimard, Paris, 1962, f. 26.

⁸ Yves Stalloni, *Écoles et courants littéraires*, Armand Colin, Paris, 2015, f. 166.

vepruar. Nëse nuk e pranon marksizmin, postulatet filozofike të të cilit i duken të pabaza, ai nuk kupton se ekzistencializmi mund të kredhet fare lehtë në kontemplacionin e vet të zhveshur. Ai proklamon njëherit, për habi të lexuesve të *Neverisë* (në të cilën njeriu është i *përrjashtuar*), për habi të lexuesve të *Qenies dhe hiçi*, se *ekzistencializmi është humanizëm*.

Procesi filozofik duhet të gjejë kontinuitetin e vet në veprime dhe duke qenë më subtil në përcaktimin e gjësendeve, ai duhet të përfundojë me moral, moral individual dhe moral të njeriut në suaza të shoqërisë. *Angazhimi* i shkrimtarit është një nga aspektet e këtij morali. Ai paraqet njërën nga format e *përgjegjësisë* së filozofit, si pasojë e domosdoshme për teorinë e tij mbi lirinë. Kjo do të thotë se shkrimtari nuk është prijës i artit, se arti është për të mënyrë e të shprehurit dhe transformimit të botës.⁹

Kushti i parë është se ai duhet të jetë në mesin e njerëzve dhe prej të gjitha atyre kuptimeve që i propozojnë ata, t'i zgjedhë ato që njerëzimit i ndihmojnë për ta zbuluar vetveten, ta modifikojë fatin e vet në kuptim të pajisjes me dije më të lartë, të pajisjes me më pak mjeshtri të gabueshme. Artisti nuk i përshkruan shfaqjet, ai është vetë aktor. Ajo që del nga goja e tij duhet të kontribuojë për t'u vënë në lëvizje tërësia që është e lidhur për të dhe së cilës i takon edhe ai vetë. Bëhet fjalë për angazhimin e shkrimtarit në veprën e tij.¹⁰

Sartre-i nuk thotë se ky angazhim filozofik duhet të shpjerë patjetër drejt angazhimit shoqëror e politik. Pak nga pak, do të vërehet se ky i fundit do të dalë si pasojë e të parit, e në realitet i pari ndërthen në vete të dytin. Si do ta ndjejë shkrimtari veten *përgjegjës* ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve, ndaj ecurisë së botës, pa marrë më në fund qëndrim pragmatik, jashtë veprës. Koncepti *përgjegjësi*, që vihet në lidhje me shkrimtarin, paraqitet më 1945 në paraqitjen e *kohëve moderne*.¹¹

Përfundimi

Sartre-i e definon përsëri natyrën e fjalës angazhim dhe e sqaron me shembuj që habisin. Ai konsideronte se Flaubert-i dhe Goncourt-i janë përgjegjës për përmytjen që erdhi pas Komunës së Parisit, sepse ata nuk kanë shkruar asnjë fjalë për ta penguar këtë gjë. Kjo është fare e qartë se angazhimi nuk do të duhej të jetë vetëm moral e parimor. Nuk angazhon mendimi, po veprimi. Kur është fjala për shkrimtarin, fjala është ajo që angazhon.

Heshtja, me çfarëdo preteksti, për çfarëdo çështje që të jetë fjala, do të thotë të mos e pranosh detyrën që ta ka ngarkuar tërësia e botës, të cilën shkrimtari duhet ta shprehë. Heshtja është cungim i kësaj bote dhe i vetvetes së shkrimtarit, me një fjalë të tërthortë filozofike, Sartre-i zbulon *misionin* e poetit romantik, të poetit të natyrës dhe të *zërit* të njerëzimit.¹²

Kjo pozitë, jo aq larg pozitës së *shkrimtarëve* nga dekada e tretë, sipas së cilës të shkruarit është dashur të shërbejë për zbulimin e botës borgjeze, kishte për qëllim të bëhet dorë ndihmëse në emancipimin e klasës shfrytëzuese. Sartre-i shërbëhet me analizën marksiste, madje edhe deri në karikaturë, kur thotë se Proust-i duke shkruar veprën e tij *Në kërkim të kohës së humbur*, është deklaruar borgjez... si pjesëmarrës i propagandës borgjeze.¹³

Referencat

- [1]. Berisha, B. (2016). *Filozofimi midis logjikës dhe absurdit*, Tetovë: Çabej.
- [1]. Brée, G. (1972). *Camus and Sartre*, New York: Delta Books.
- [2]. Breisach, E. (1962). *Introduction to Modern Existentialism*, New York: Grove Press.
- [3]. Deguy, J. (1993). *'La nausée' de Jean-Paul Sartre*, Paris: Gallimard.

⁹ Lubisha Stefanoviq, *Zhan-Pol Sartri romancier*, Jehona nr. 6, Shkup, 1972, f. 29.

¹⁰ Луан Старова, *Литература и ангажман*, Мисла, Скопје, 1979, f. 383.

¹¹ Jean-Paul Sartre, *Ekzistencializmi është humanizëm*, Phoenix, Tiranë, 1997, f. 15.

¹² Beqir Berisha, *Filozofimi midis logjikës dhe absurdit*, Çabej, Tetovë, 2016, f. 134.

¹³ Lubisha Stefanoviq, *Zhan-Pol Sartri romancier*, Jehona nr. 6, Shkup, 1972, f. 31.

- [4]. Kaufmann, W. (2011). *Ekzistencializmi nga Dostojevski te Sartri*, Tiranë: Plejad.
- [5]. Lévy, B-H. (2000). *Le Siècle de Sartre*, Paris: Grasset.
- [6]. Mounier, E. (1962). *Introduction aux existentialismes*, Paris: Gallimard.
- [7]. Sartre, J-P. (1997). *Ekzistencializmi është humanizëm*, Tiranë: Phoenix.
- [8]. Sartre, J-P. (2005). *Muri*, Prishtinë: Koha ditore.
- [9]. Sartre, J-P. (2014). *Neveria*, Tiranë: Fan Noli.
- [10]. Shabani, E. (2017). *Studime letrare*, Tetovë: Arbëria Design.
- [11]. Stalloni, Y. (2015). *Écoles et courants littéraires*, Paris: Armand Colin.
- [12]. Старова, Л. (1979). *Литература и ангажман*, Скопје: Мисла.
- [13]. Stefanoviq, L. (1972). *Zhan-Pol Sartri romancier*, Shkup: Jehona nr. 6.
- [14]. Visoka, A. (2011). *Koha e shkrimit*, Prishtinë: 99-AIKD.